

Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

I. Hyrje dhe prioritetet e misionit

1. Ky raport dorëzohet në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit, përmes secilës Këshilli themeloi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe kërkoi nga unë që të raportoj në intervale të rregullta lidhur me zbatimin e mandatit të tij. Në raport mbulohen aktivitetet e UNMIK-ut dhe zhvillimet lidhur me to, duke filluar nga data 16 shtator 2019 deri më 15 mars 2020.
2. Prioritetet e misionit mbesin avancimi i sigurisë, stabilitetit dhe i respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë dhe në regjion. Në çuarjen përpara të qëllimeve të tij, UNMIK-u vazhdon angazhimin e tij konstruktiv me Prishtinën dhe Beogradin, me të gjitha komunitetet në Kosovë, si dhe me palët regjionale e ndërkombëtare. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Forca e Kosovës (KFOR) vazhdojnë me përmbushjen e roleve të tyre brenda kornizës së Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit. Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) vazhdon praninë e tij në Kosovë në përputhje me deklaratën e kryetarit të Këshillit të Sigurimit, të datës 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44) dhe me raportin tim, të datës 24 nëntor 2008 (S/2008/692). Agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara kanë bashkëpunim të ngushtë me Misionin.

II. Zhvillimet kryesore politike dhe të sigurisë

3. Pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme të datës 6 tetor 2019, ku partitë opozitare shënuan rezultate të mira, një periudhë e tejzgjatur e numërimit të votave, e ankesave zgjedhore dhe e negociatave për koalicion përfundoi me fillimin e mandatit të ri të Kuvendit të Kosovës më 26 dhjetor 2019 dhe me formimin e qeverisë së re më 2 shkurt 2020. Konjuktura e re politike parqet daljen e një brezi të ri të udhëheqësve politikë dhe suksesin e kandidateve të reja femra, ku kemi përqindjen më të lartë të femrave deputete dhe zgjedhjen për herë të parë të një femre për kryetare të Kuvendit. Qeveria e re i ka parashtruar prioritetet e saj me theks të veçantë në reformën e gjyqësorit, luftimin e kimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe në rritjen e zhvillimit ekonomik.
4. Zgjedhjet e jashtëzakonshme u mbajtën në të gjitha 38 komunat e Kosovës, me një dalje të votuesve prej 44.56 për qind. Dalja në zgjedhje e votuesve në dhjetë komunat e

Kosovës me shumicë serbe ishte më e larta deri më tani, ku votuan gjithsej 48.6 për qind e qytetarëve me të drejtë vote. Përkundër mbajtjes me rregull të zgjedhjeve, certifikimi i rezultateve zgjedhore është vonuar për shkak të numrit të madh të ankesave zgjedhore, të parashtruara nga entitetet politike. Parregullsitë e zbuluara në formularët e rezultateve nxitën Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia që të urdhëroj rinumërimin e votave në 88% të vendvotimeve. Për më tepër, më 13 tetor, Policia e Kosovës evakuoi objektet e përdorura për verifikimin e votave të ardhura me postë pasi që 26 punonjës të Komisionit Qendror Zgjedhor raportuan simptome alergjike pas kontaktit me fletëvotimet e ardhura nga Serbia. Këtë incident e hetoj Zyra e Prokurorisë dhe Policia e Kosovës, të cilat nuk kanë paraqitur gjetjet e tyre deri në fund të kësaj periudhe raportuese. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka përpunuar dhe numëruar 3782 pako të fletëvotimeve nga Serbia më 23 tetor, por më 7 nëntor votat janë anuluar pas një procesi ankimor me arsyetimin se fletëvotimet me postë nga Serbia janë sjellë nga “individë të paautorizuar” dhe jo me postë të rregullt. Shpallja e pavlefshme e këtyre votave të ardhura me postë zvogëloi numrin e përgjithshëm të votave dhe, rrjedhimisht, edhe numrin e votave të nevojshme për arritjen e pragut zgjedhor prej pesë për qind. Në këtë kontekst, koalicioni parazgjedhor i Nismës Socialdemokrate të Kosovës, Aleancës Kosova e Re dhe i Partisë së Drejtësisë siguroi gjashtë ulëse në Kuvend.

5. Rezultatet e certifikuar të shpallura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më 27 nëntor 2019 treguan se asnjë entitet politik nuk kishte fituar shumicën prej 120 vendeve në Kuvend. Në mesin e partive shqiptare, Vetëvendosje (“Lëvizja Vetëvendosje”) mori 26,27 për qind të votave dhe 29 ulëse në Kuvend, e pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës me 24,54 për qind të votave dhe 28 ulëse. Nga entitetet e tjera politike shqiptare, Partia Demokratike e Kosovës fitoi 21.23 për qind të votave, duke siguruar 24 ulëse në Kuvend. Koalicioni parazgjedhor mes Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Partisë Socialdemokrate të Kosovës doli i katërti me 11,51 për qind dhe 13 ulëse. Lista Serbe siguroi të gjitha dhjetë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komunitetit serb të Kosovës, ndërsa përfaqësuesit e komuniteteve të tjera joserbe së bashku i plotësuan dhjetë ulëset e garantuara për ta. Numri i femrave deputete në këtë legjislaturë e kaloi kuotën prej 30 për qind për dy për qind, ku prinë femrat kandidatë nga Vetëvendosja, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lista Serbe, të cilat fituan ulëset në Kuvend pavarësisht kuotës së paraparë me ligj. Vëzhguesit vendorë dhe ndërkombëtarë të zgjedhjeve i vlerësuan ato si mirë të administruara dhe transparente. Megjithatë, Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve në Kosovë theksoi se mjedisi i fushatës zgjedhore në zonat e banuara me shumicë serbe u “njollosoi prej ngacmimeve”.
6. Zgjedhjet u pasuan me katër muaj negociata mes Vetëvendosjes dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës për formimin e koalicionit qeverisës. Pika kryesore e mospajtimit në proces ishte nominimi i kandidatit për president të Kosovës në vitin 2021.

Më 26 dhjetor u konstituua Kuvendi i Kosovës me zgjedhjen për kryetar Kuvendi të kandidatit të Vetëvendosjes, Glauk Konjufca. Edhe pse deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahen krijimin e legjislaturës së re, çështja e kryetarit të Kuvendit përfundimisht i zgjodh në një marrëveshje pasuese mes Vetëvendosjes dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës më 2 shkurt. Sipas kësaj marrëveshjeje, z. Konjufca, dha dorëheqje nga ky post më datën 3 shkurt, duke mundësuar kështu zgjedhjen me shumicë votash të Albin Kurtit nga Vetëvendosja për kryeministër të Kosovës dhe të Vjosa Osmanit nga Lidhja Demokratike e Kosovës, për kryetare të parë femër të Kuvendit. Edhe pse Lista Serbe abstenoj nga votimi për krijimin e qeverisë, ajo votoi për znj. Osmani për kryetare të Kuvendit. Qeveria e re e koalicionit përbëhet nga dy zëvendëskryeministra, 15 ministra dhe 35 zëvendësministra, ku Vetëvendosja dhe Lidhja Demokratike e Kosovës kanë secila nga gjashtë ministri; Lista Serbe dy ministri dhe komunitetet e tjera joshumicë një ministri. Kabineti i ri është riorganizuar, duke u zvogëluar nga 21 ministri sa ka qenë i mëparshmi dhe është më përfaqësuesi sa i përket aspektit gjinor që nga viti 2008, ku tani pesë ministri udhëhiqen nga gratë.

7. Qeveria e re ka ndërmarrë hapat fillestarë për trajtimin e keqqeverisjes së pretenduar të qeverisë së kaluar. Kështu, në shkurt ka shkarkuar bordin e drejtorëve të ndërmarrjes publike Telekom i Kosovës dhe ka anuluar konkursin publik për emërimin e noterëve të rinj, të cilin e kanë kritikuar organizatat e shoqërisë civile të Kosovës dhe disa palë ndërkombëtare si jotransparent dhe të pabazuar në merita.
8. Dialogu i ndihmuar nga Bashkimi Evropian ka ngecur, edhe pse përpjekjet ndërkombëtare për inkurajimin e rifillimit të tij vazhduan. Gjatë vizitës së tij në Prishtinë dhe Beograd në janar 2020, përfaqësuesi i ri i lartë i Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë dhe zëvendëspresidenti i Komisionit Evropian, Josep Borrell, konfirmoi përkushtimin e Bashkimit Evropian për avancimin e procesit të dialogut. Më 23 janar, përpjekjet e Shteteve të Bashkuara, të udhëhequra nga i dërguari i posaçëm presidencial për negociatat paqësore mes Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, kulmuan me nënshkrimin e letrave të ndara të qëllimit nga të dyja palët me një aviokampani gjermane për rihapjen e fluturimeve direkte komerciale mes Beogradit dhe Prishtinës. Më 14 shkurt, përfaqësuesit e Beogradit dhe Prishtinës nënshkruan letrat e tjera për rihapjen e lidhjes hekurudhore dhe ndërtimin e autoudhës mes dy qyteteve.
9. Më 7 shkurt në Prishtinë, KFOR-i dhe qeveria e Islandës nënshkruan marrëveshjen kornizë lidhur me hapjen e linjave të tjera komerciale në hapësirën e ulët ajrore mbi Kosovë. Sipas marrëveshjes, Islanda do të ofronte shërbimet e navigacionit ajror në hapësirën e ulët ajrore nën autoritetin e përgjithshëm të KFOR-it. UNMIK-u mirëpriti nismat që ishin në përputhje me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit dhe me

Marrëveshjen Ushtarake Teknike të vitit 1999, si dhe të pranueshme për Prishtinën, Beogradin dhe për palët e tjera me interes.

10. Pas formimit të qeverisë së Kosovës, palët ndërkombëtare theksuan nevojën për rifillimin e shpejtë të dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës. Më 13 dhe 14 shkurt, presidenti i Francës, Emmanuel Macron, dhe sekretari i shtetit i Shteteve të Bashkuara, Michael R. Pompeo, dërguan letra të ndara kryeministrit Kurti, ku kërkohej nga qeveria e Kosovës t'i heq të gjitha pengesat për negociatat e mëtejme, në veçanti, të heq tarifën 100 për qind për mallrat nga Serbia dhe Bosnje Hercegovina. Njëkohësisht, SHBA-ja dhe palët evropiane kanë kërkuar nga Beogradi që t'a ndal "fushatën e mosnjohjeve kundër Kosovës." Edhe pse udhëheqësit politikë në Beograd dhe Prishtinë kanë konfirmuar gatishmërinë e tyre për rifillimin e dialogut, ata gjithashtu e lidhën këtë rifillim me kushte kundërtënëse. Kryeministri Kurti ka ngulmuar në futjen e politikës së "reciprocitetit të plotë komercial" dhe që Beogradi të ndal fushatën e tij për tërheqjen e njohjeve të Kosovës, ndërsa Beogradi ka theksuar nevojën për heqje të plotë dhe të pakushtëzuar të tarifës dhe ndaljen e përpjekjeve të Prishtinës për fitimin e njohjeve ndërkombëtare. Më 27 shkurt, kryeministri Kurti propozoi heqjen e pjesshme të tarifës më 15 mars, e cila do të pasohej me heqje të plotë duke filluar nga data 1 prill, varësisht edhe nga përkushtimi i Beogradit për heqjen e të gjitha barrierave tregtare jotarifore dhe ndalimin e "fushatës jomiqësore". z. Kurti tha se nëse Beogradi nuk i plotëson këto kushte, Prishtina gradualisht do të zbaton "parimin e reciprocitetit" në tregti dhe në fushat ekonomike e politike, si dhe do të kthej tarifën e tanishme nga data 15 qershor 2020. Megjithatë, partneri i koalicionit qeverisës, Lidhja Demokratike e Kosovës, kërkoi heqjen e plotë të tarifës dhe jo masat graduale, siç u propozuan nga kryeministri. Për shkak të pikëpamjeve kundërtënëse brenda koalicionit qeverisës, z. Kurti deklaroi më 15 mars se tarifa 100 për qind do të mbetet derisa kabineti të arrijë konsensusin për mënyrën e ecjes përpara.
11. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, pas takimit me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në Shtëpinë e Bardhë në Uashington më 2 mars theksoi nevojën e zgjidhjes paqësore të çështjeve mes Kosovës dhe Serbisë dhe mundësinë e arritjes së marrëveshjes përfundimtare. Më 15 mars 2020, Kuvendi i Kosovës miratoi rezolutën, përmes së cilës konfirmohet përkushtimi i Prishtinës për angazhim në negociata politike me Beogradin që do të rezultojnë me njohje të ndërsjellë. Po ashtu, rikonfirmoi mandatin e qeverisë së Kosovës për të udhëhequr dialogun me Beogradin në përputhje me Kushtetutën dhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të qershorit 2019 (shih S/2019/797/par.7) dhe deklaroi se integriteti territorial dhe karakteri unitar i Kosovës nuk është i negociueshëm.
12. Sa i përket gjendjes së sigurisë në Kosovë, janë shënuar një numër incidentesh në vendet fetare dhe në varreza. Në tetor, ka pasur vjedhje në dy kisha ortodokse në Vushtrri dhe Shtërpce, si dhe janë vjedhur dy monumente nga kisha katolike në Pejë në muajin

dhjetor. Ka pasur gjithashtu raportime të vandalizmit në vendet fetare të komunitetit protestant në Gjilan dhe në ato të komunitetit islam në Prizren në muajt shtator, përkatësisht nëntor. Po ashtu janë përdhosur edhe disa gurë të varrezave të serbëve në Lipjan dhe Istog. Përfaqësuesi im Special ka shprehur shqetësime serioze për përdhosjen e gurëve të varrezave në varrezat ortodokse në Lipjan, ku incidenti i ngjashëm kishte ndodhur edhe në korrik të vitit 2019 (S/2019/797, par. 11).

13. Periudha raportuese ka shënuar rritje të ndjekjes penale të veprave të ndërlidhura me terrorizimin. Nga 16 shtatori 2019 deri më 25 shkurt 2020, 35 individë (24 gra dhe 11 meshkuj) janë akuzuar, ku 23 prej tyre (17 gra dhe gjashtë meshkuj) janë dënuar për akuza të ndërlidhura me terrorizimin. Nga këta të dënuar, 16 gra dhe tre meshkuj kanë qenë pjesë e grupit prej 110 personave (74 fëmijë, 32 gra dhe katër meshkuj) që ishin riatdhesuar nga Republika Arabe e Sirisë në Kosovë në prill të vitit 2019 (S/2019/461, par. 16). Të gjitha gratë janë deklaruar të pafajshme për “organizim dhe pjesëmarrje në grupin terrorist”, dhe kanë marrë dënime me kusht prej dy deri në tri vite burg dhe këshillime obligative psikologjike. Tre meshkujt u dënuan me burg, duke filluar nga gjashtë muaj deri në 5 vite e gjysmë. Të 74 fëmijët vazhdojnë të jetojnë me të afërmit e tyre. Misioni vazhdoj t’i monitorojë këto raste dhe procesin më të gjerë të riintegritimit në bashkërendim me ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe me palët ndërkombëtare. Gjatë periudhës në shqyrtim, Organizata Ndërkombëtare për Migrim përkrahu Divizionin për parandalim dhe riintegrim të Ministrisë së Punëve të Brendshme përmes hartimit të udhëzimeve për riintegrim dhe vlerësim të përbashkët të rasteve specifike të nevojave për riintegrim, si dhe ofroj ngritje të kapaciteteve pushtetit vendor dhe qendror për lehtësimin e këtij procesi.

III. Kosova veriore

14. Zhvillimet politike në Kosovën veriore u fokusuan në zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit. Lista Serbe fitoj në të gjitha katër komunat e Kosovës, ku u regjistrua dalja më e madhe e votuesve deri më tani, duke marrë prej 81 deri 92 për qind të votave.
15. Më 28 shkurt, qeveria e Kosovës shkarkoi Bordin mbikëqyrës të Trepçës për shkak të shkeljeve të pretenduara të detyrave fiduciare, keqmenaxhimit të aseteve dhe procesit të rekrutimit. Vendimit të qeverisë i kanë paraprirë protestat më shumë se dyjavore në Mitrovicë të Jugut nga të punësuarit potencialë të kompanisë minerare, të cilët pretendonin se praktikat e rekrutimit të kompanisë nuk ishin të bazuara në merita dhe i nënshtrheshin ndikimit politik.
16. Më dhjetor të vitit 2019, Prokuroria Speciale e Kosovës ngriti padi kundër gjashtë individëve (pesë meshkuj dhe një grua) për vrasjen e politikanit serb Olliver Ivanoviq në

janar të vitit 2018. Të pandehurit u akuzuan për pjesëmarrje në grup të organizuar kriminal që vepronte në veri të Kosovës. Në mesin e të akuzuarve janë dy zyrtarë policorë që akuzohen për dështim në sigurimit e skenës së krimit dhe fshehjen apo shkatërrimin e dëshmimeve. Gjatë seancës fillestare, të mbajtur më 11 shkurt në gjykatën themelore të Prishtinës, të gjithë të akuzuarit u deklaruan të pafajshëm për akuzat e ngritura. Më 2 dhjetor, drejtori i Zyrës për Kosovë e Metohi i qeverisë së Serbisë, Marko Gjuriq, si dhe Lista Serbe vuan në pyetje besueshmërinë dhe paanësinë e procesit gjyqësor dhe akuzuan Prishtinën për mosbashkëpunim me autoritetet e Serbisë në procesin e hetimeve.

IV. Kthimet, pajtimi, trashëgimia kulturore dhe marrëdhëniet mes komuniteteve

17. Gjatë periudhës raportuese, Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) ka shënuar 152 kthime vullnetare të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë që kanë qenë të zhvendosur brenda Kosovës dhe jashtë saj. Nga të kthyerit, 75 ishin femra dhe 77 meshkuj (87 serbë, 33 romë, 28 egjiptianë dhe 4 ashkali). Duke përfshirë të kthyerit e fundit, gjithsej numri i personave të zhvendosur të komuniteteve joshumicë, të cilët kanë gjetur zgjidhje të qëndrueshme në Kosovë që nga viti 2000 është 28358 - 13919 femra dhe 14439 meshkuj (12091 serbë, 7634 egjiptianë dhe ashkali, 3968 romë, 1875 boshnjakë, 1464 goranë, 1282 shqiptarë, 21 malazez, 19 turq dhe 4 kroatë). Brenda Kosovës mbesin 16121 persona të zhvendosur (7442 femra dhe 8679 meshkuj) si dhe 69627 persona me nevoja të lidhura me zhvendosjen në mbarë Ballkanin Perëndimor. Nga përafërsisht 200000 persona të zhvendosur nga Kosova e që banojnë në regjion, shumica prej tyre gjenden në Serbi.
18. Më 12 shkurt, UNMIK-u në partneritet me UNHCR-në dhe Ministrinë për Komunitete dhe Kthime të Kosovës, kanë filluar një numër takimesh bashkërenduese me zyrtarët komunalë që janë përgjegjës për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të komuniteteve dhe për kthime. Në takim kanë marrë pjesë përfaqësuesit e 11 komunave nga regjioni i Gjilanit, si dhe autoritetet qendrore, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe të bashkësisë ndërkombëtare. Pjesëmarrësit diskutuan sfidat kryesore të personave të zhvendosur dhe të procesit të kthimeve vullnetare, ku u pajtuan që të rrisin bashkërendimin dhe bashkëpunimin institucional që ka për qëllim lehtësimin e zgjidhjeve të qëndrueshme. Takimi i dytë është mbajtur më 26 shkurt, i cili u bashkorganizua nga Ministria për Kthime dhe Komunitete dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ku morën pjesë përfaqësuesit e dhjetë komunave nga regjioni i Prishtinës, autoritetet qendrore, shoqëria civile dhe përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare.
19. Nga data 25 deri 26 nëntor 2019, një grup teknik punues i përbërë nga përfaqësuesit e Beogradit, Podgoricës, Prishtinës dhe Shkupit u takua në Maqedoninë e Veriut në kuadër

të nismës regjionale të përkrahur nga UNHCR-ja dhe OSBE-ja, të njohur si Procesi i Shkupit, për mbështetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova. Pjesëmarrësit diskutuan zbatimin e pikave të veprimit të dakorduara më herët dhe miratuan një koncept dokument lidhur me zgjidhjet e qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova dhe brenda saj, që paraqet kornizën për zgjidhje të qëndrueshme dhe fton për përkushtim dhe zgjidhje me kohë të çështjes së personave të zhvendosur në regjion.

20. Më 18 nëntor 2019, eparkia e Rashkës dhe Prizrenit shprehu shqetësimin lidhur me një numër ngjarjes kulturore dhe shërbimesh fetare që po zhvillohen në rrënojat e kishës së Shën Nikollës në komunën e Novobërdës si në kundërshtim me Ligjin për zonat e posaçme të mbrojtura. Gjatë periudhës raportuese, përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Serbe gjithashtu ngritën shqetësime lidhur me moszbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të datës 19 maj 2016, ku u vendos në favor të pronësisë së 24 hektarëve tokë nga manastiri i Deçanit. Këshilli për zbatim dhe monitorim, i cili mbikëqyrë zonat e posaçme të mbrojtura përreth vendeve fetare, nuk është takuar gjatë periudhës së raportimit për shkak të procesit të tejzgjatur zgjedhor dhe të formimit të qeverisë.
21. Gratë përfaqësuese të komuniteteve ashkali, egjiptiane dhe rome, grupet e shoqërisë civile dhe autoritetet vendore morën pjesë në diskutimin e grupit të fokusit për fuqizimin e gruas më datat më 30 shtator dhe 15 tetor 2019. Ky diskutim që u organizua nga Koordinatori për zhvillim i Kombeve të Bashkuara, UNHCR dhe Entiteti për barazi gjinore dhe fuqizimin e gruas i Kombeve të Bashkuara (UN-Women) u fokusua në mënyrat e trajtimit të mungesës së shkollimit dhe të mundësive të punësimit, si dhe të qasjes së kufizuar në shërbime publike, të cilat janë identifikuar si pengesat kryesore për fuqizimin e gruas tek komunitetet joshumicë. UNHCR-ja gjithashtu ka vazhduar me përkrahjen e anëtarëve të komuniteteve shkali, egjiptiane dhe rome në marrjen e dokumentacionit civil dhe zgjidhjen e çështjeve të statusit civil për të mundësuar qasjen e tyre në shërbime të ndryshme publike. UNHCR-ja u ofrojë ndihmë juridike 159 individëve (90 femra dhe 69 meshkuj) në kryerjen e punëve të regjistrimit civil. Po ashtu, 85 individë (49 femra dhe 36 meshkuj) kanë marrë përkrahje në qasje dhe përfitim nga shkollimi, ndihma sociale, të drejtat pronësore dhe ato të pensionit.
22. UNHCR-ja gjithashtu u ka ofruar përkrahje psikologjike 42 viktimave të identifikuara të dhunës seksuale dhe gjinore nga komunitetet ashkali, egjiptase dhe rome.
23. Kanë vazhduar përpjekjet për tërheqjen e kontributeve vullnetare për fondin e mirëbesimit në mbështetje të komuniteteve ashkali, egjiptase dhe rome të prekura nga helmimi me plumb në Kosovë. Fondi i mirëbesimit është themeluar në vitin 2017 në

pajtim me rekomandimet e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut të UNMIK-ut. Gjatë periudhës në shqyrtim nuk ka pasur kontribute.

V. Sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut

24. Gjatë periudhës raportuese, sistemi gjyqësor i Kosovës ka ngritur akuza kundër disa individëve të profilit të lartë. Në dhjetor 2019, Zyra e Prokurorisë Speciale e Kosovës ka ngritur akuzë ndaj ish-ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nga Lista Serbe, Nenad Rikallo, dhe ish-ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar. Në shkurt, Gjykata e Apelit nxori aktgjykimin e formës së prerë ku ish-sekretari i Ministrisë së Shëndetësisë, së bashku me disa punonjës të tjerë të ministrisë u shpallen fajtorë për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe, në një rast tjetër, vërtetoi dënimin e paprecedentë deri më tani në rastin e shpëlarjes së parave dhe urdhëroi konfiskimin e pasurisë në vlerë prej gati një milion euro. Njëkohësisht, të gjithë të akuzuarit e rastit Pronto, ku përfshiheshin zyrtarë të lartë të Partisë Demokratike të Kosovës, në janar u shpallen të pafajshëm në një aktgjykim të shkallës së parë të gjykatës themelore të Prishtinës. Prokurori i rastit ka marrë kërcënime me vdekje në mediet sociale, ku akuzohej se nuk ka dhënë argumente të forta kundër individëve të akuzuar. I dyshuari për kërcënime më pas është arrestuar dhe është lëshuar urdhri për qëndrim e tij larg nga personi i kërcënuar.
25. Gjykatat e Kosovës gjithashtu kanë ngritur aktakuza dhe kanë shpallur aktgjykime për rastet e krimeve të luftës. Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës ka ngritur aktakuzë ndaj katër individëve për tri raste të krimeve që pretendohet të jenë kryer kundër civilëve në vitin 1999 në komunën e Prishtinës, Ferizajt dhe të Lipjanit. Seancat dëgjimore janë mbajtur për të tria rastet. Gjatë periudhës raportuese, Gjykata e Apelit liroj njërin prej të akuzuarve për krime të luftës kundër popullatës civile në komunën e Klinës në vitin 1999, dhe zvogëloj dënimin e akuzuarit tjetër nga 14 vite në 10 vjet heqje lirie për rastin e krimit të kryer në komunën e Suharekës. Për dy raste të tjera lidhur me krimet që pretendohet të jenë kryer në komunat Prizren dhe Pejë, gjykimi është në vazhdim e sipër.
26. Më 24 shkurt, pas marrjes së njoftimit nga Prokurori i Specializuar për qëllimin e tij të nisjes së procedurave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, kryetari i Dhomave caktoi një gjyqtar të procedurës paraprake për t'i shqyrtuar aktakuzat të ngritura nga Prokurori i Specializuar. Sipas rregullores së punës në fuqi, aktakuzat ngritën në mënyrë konfidenciale, dhe gjyqtari i procedurës paraprake ka deri në gjashtë muaj kohë nga ngritja e aktakuzës për të nxjerrë vendimin, përmes të cilit aktakuza konfirmohet apo hidhet poshtë.

27. Në shkurt, ekipi përgatitor për themelimin e Komisionit të Kosovës për të Vërtetën dhe Pajtimin mbajti edhe një raund të konsultimeve publike me anëtarët e shoqërisë civile, intelektualët dhe komunitetet vendore në mbarë Kosovën për të diskutuar mënyrat e funksionimit të këtij Komisioni. Ekipi përgatitor që është themeluar me iniciativë të presidentit Thaçi në shkurt të vitit 2018, përbëhet nga përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe grupeve të shoqërisë civile nga komuniteti shumicë dhe ata joshumicë. Megjithatë, një anketë publike e realizuar nga organizata vendore joqeveritare Integra, e paraqitur më 4 mars, sugjeroi se përderisa ekzistonte përkrahja e përgjithshme publike për nismat që do të ndihmonin në zbulimin e së vërtetës lidhur me ngjarjet e viteve 1998-1999, shumica e të intervistuarve nuk ishin në dijeni me konceptin e së drejtës në të vërtetën dhe jo domosdo mund të bënin dallimin ndërmjet procesit të pajtimit mes komuniteteve në Kosovë dhe dialogut më të gjerë politik mes Beogradit dhe Prishtinës.
28. UNMIK-u vazhdoi t'i ofron përkrahje Grupit punues për persona të zhdukur lidhur me ngjarjet në Kosovë. Në shtator 2019, pas javësh të mospajtimeve për procedurat, delegacioni i Prishtinës, në prani të delegacionit të Beogradit, ia dorëzoi mbetjet mortore të pesë anëtarëve të një familje serbe Komisionit për Persona të Zhdukur të Malit të Zi. Mbetjet e dy personave të tjerë, të identifikuar si anëtarë të një familje tjetër serbe, i janë dorëzuar autoriteteve në Beograd në fillim të shtatorit. Në kuadër të një zhvillimi të mirëpritur, Grupi punues ka rifilluar aktivitetet në shkurt 2020, ku të dyja delegacionet u pajtuan që të fuqizojnë kapacitetet analitike të Grupit punues dhe t'i bëjnë së bashku një numër vlerësimesh të vendeve të mundshme gjatë muajve në vijim. Sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, deri në shkurt të vitit 2020, 1646 persona, nga gjithsej 6064, ende mbesin të zhdukur.
29. Në nëntor të vitit 2019, UNMIK lehtësoi një numër sesionesh të ngritjes së kapaciteteve dhe hartimit të dokumenteve për Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë dhe për Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Kjo ka rezultuar në janar 2020 me nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit mes dy institucioneve, ku pasqyrohet përkushtimi i tyre për zbatimin e të drejtave të njeriut dhe qasjes gjinore në grumbullimin, analizën dhe përdorimin e të dhënave. Futja e aspektit të barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut në grumbullimin e të dhënave do të përmirësojë monitorimin dhe vlerësimin e përparimit në aspektin e të drejtave të njeriut dhe do të ndihmojë në sigurimin që zotimet e institucioneve të Kosovës në kuadër të Agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030 të zbatohen në përputhje me ligjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
30. Puna e Avokatit të Popullit në largim ka rezultuar me të arritura domethënëse që kanë kontribuar në avancimin e kulturës së të drejtave të njeriut në Kosovë. Raportet mirë të dokumentuara të Avokatit të Popullit kanë ofruar një bazë solide për avancimin e llogaridhënies rreth të drejtave të njeriut, siç pasqyrohet në një numër të rritur

rekomandimesh të zbatuara nga autoritetet e Kosovës. Avokati i Popullit ka kontribuar në mënyrë të efektshme në parandalimin e torturës dhe trajtimit tjetër të vrazhdë, çnjerëzor e poshtëruës.

VI. Gratë, paqja dhe siguria

31. Gjatë periudhës raportuese, komisioni i qeverisë së Kosovës që është përgjegjës për verifikimin dhe njohjen e statusit të të mbijetuarit të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin, ka pranuar 143 aplikacione, duke e çuar gjithsej numrin e aplikacioneve të pranuar që nga themelimi në vitin 2018 në 1226. Deri më sot, 785 aplikues (758 femra dhe 27 meshkuj) kanë fituar statusin e të mbijetuarit. Lidhur me këtë proces, ende ka sfida në vlerësimin e aplikacioneve për shkak të ndjeshmërisë dhe ndërlikueshmërisë së rasteve. Më 12 nëntor 2019, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë ka nisur hetimin për procesin e vlerësimit pas pranimit të ankesave nga dy individë, aplikacionet e të cilëve për statusin e të mbijetuarit komisioni i ka refuzuar. Më 6 mars 2020, Zyra e Prokurorisë Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë kundër ish-pjesëtarit të forcave rezerve të policisë së Serbisë për krimet që pretendohet të jenë kryer kundër popullatës civile shqiptare të Kosovës në maj të vitit 1999, duke përfshirë edhe krimet seksuale të lidhura me konfliktin. Kjo është aktakuza e parë e ngritur nga prokuroria vendore për dhunën seksuale të lidhur me konfliktin si krim të luftës që nga përfundimi i mandatit ekzekutiv të EULEX-it në vitin 2018.
32. Nga data 25 nëntor deri më 10 dhjetor 2019, në Kosovë është shënuar fushata globale vjetore “16 Ditë të aktivizmit kundër dhunës gjinore”, ku janë zhvilluar më shumë se 100 aktivitete, të emërtuara “Ngjyrosni botën me të portokalltë: Barazia e gjeneratave ngreh zërin kundër dhunës!”. Filmi dokumentar i prodhuar nga UNMIK-u “Nuk është prona e jote”, ku paraqiten femrat e mbijetuara të përkatësive të ndryshme etnike, është shfaqur në 11 nga 38 komunat e Kosovës, i cili gjithashtu ofrojë një platformë për femrat e mbijetuara për të ndarë historitë e tyre dhe për t’i inkurajuar të tjerët që të flasin. Grupi shumëpalësh për barazi gjinore dhe siguri i udhëhequr nga UN-Women, ku merr pjesë edhe UNMIK-u, ftoj qeverinë e re të Kosovës që të prioritetizojë trajtimin e dhunës seksuale dhe t’i mbroj e përkrah të mbijetuarit.
33. Kombet e Bashkuara në Kosovë kanë vazhduar të ndihmojnë në avancimin e pjesëmarrjes së grave në politikë. Më 21 shtator 2019, UNMIK-u, në partneritet me UN-Women dhe Lobin Regjional të Grave në Evropën Juglindore, kanë organizuar një tryezë të rumbullakët regjionale në Prishtinë për fuqizimin e gruas në proceset e ndërtimit të paqes dhe të vendimmarrjes. Mes dhjetorit 2019 dhe shkurtit 2020, UNMIK-u, në partneritet me UN-Women dhe Bashkimin Evropian, organizoi trajnime për udhëheqje

për 15 femra udhëheqëse nga të gjitha komunitetet e Kosovës për të ndihmuar në përmirësimin e aftësisë së tyre lidhur me ndikimin në proceset politike dhe të paqes. Këtu përfshihej edhe angazhimi me rrjetin e kolegëve dhe të mentorëve të lart, si dhe ndërveprimin e anëtarët e Parlamentit Evropian dhe ekspertët në Bruksel.

VII. Ndërtimi i besimit, partneritetit dhe bashkëpunimit

34. Gjatë periudhës raportuese, UNMIK-u, në bashkëpunim të ngushtë me ekipin e Kombeve të Bashkuara të Kosovës, vazhdoi zbatimin e rekomandimeve të Forumit të Kombeve të Bashkuara për Ndërtimin e Besimit, të mbajtur në Ljubjanë në maj të vitit 2018. Deri tani, 150 institucione, organizata dhe individë kanë ndërmarrë përafërsisht 200 iniciativa në përputhje me rekomandimet e Forumit për Ndërtimin e Besimit. Shumica e këtyre përpjekjeve janë udhëhequr nga shoqëria civile, dhe rreth një e katërta e aktiviteteve të ndërlidhura zhvillohen nga institucionet e nivelit qendror e lokal.
35. Në fushën e drejtësisë, UNMIK-u vazhdoi të mbështesë integrimin e gjyqësorit dhe administrimin e drejtësisë, si pjesë e zbatimit të rekomandimeve të Forumit të Kombeve të Bashkuara për Ndërtimin e Besimit në Kosovë. Gjatë periudhës raportuese, Qendra e ndihmës juridike e Institutit Juridik të Kosovës e mbështetur nga UNMIK-u, i pranoi dhe i trajtoi 233 kërkesa për ndihmë juridike falas, duke përfshirë të drejtat pronësore të grave (44), të drejtat e punës dhe të pensionistëve (69), të drejtat e pakicave, personave të zhvendosur brenda vendit, refugjatëve dhe azilkërkuessve (35), viktimave të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore (27), të drejtat e të ndaluarve (27) dhe lëndët gjyqësore strategjike (31).
36. UNMIK-u ka vazhduar përpjekjet e tij për të ndihmuar në ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të sistemit gjyqësor për t'i shërbyer më mirë popullatës, duke përfshirë zvogëlimin e numrit të lëndëve gjyqësore në Kosovë në bashkëpunim me një organizatë joqeveritare lokale. Në nëntor të vitit 2019, UNMIK-u dhe Qendra e Avokimit për Kulturë Demokratike filluan një projekt që synonte mbështetjen e gjykatës themelore të Mitrovicës në përkthimin e dosjeve të lëndëve dhe integrimin e avokatëve të rinj serbë në praktikën ligjore të Kosovës. Në mënyrë të ngjashme, në nëntor të vitit 2019, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, me fonde programatike të siguruar nga UNMIK-u, filloi zbatimin e një projekti të përbashkët duke ndihmuar gjykatën themelore të Prishtinës, të Ferizajt dhe Gjilanit me sigurimin e përkthimit të dosjeve të lëndëve dhe trajnimit për interpretuesit e gjykatave. Më 19 shkurt, Përfaqësuesi im Special mori pjesë në një konferencë të organizuar nga Qendra e Avokimit për Kulturë Demokratike, për të vlerësuar gjendjen e gjyqësorit dhe praktikën juridike në veri të Kosovës, ku ai premtoi mbështetje të vazhdueshme për institucionet e Kosovës në fuqizimin e gjyqësorit.

Mirëpo, sfidat vazhdojnë për shkak të burimeve të pamjaftueshme buxhetore të ndara për të adresuar përdorimin e gjuhëve zyrtare në gjykata dhe lëndëve të pazgjidhura.

37. Si pjesë e një iniciativë më të gjerë për të promovuar të drejtat gjuhësore dhe për të hequr pengesat gjuhësore që parandalojnë komunitetet të ushtrojnë plotësisht liritë e tyre themelore, UNMIK-u, në partneritet me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim, më 26 nëntor 2019 publikoi fjalorin e parë standard në internet shqip-serbisht dhe serbisht-shqip. Gjatë inaugurimit, Përfaqësuesi im Special theksoi rolin thelbësor të diversitetit gjuhësor në sigurimin e një mjedisi të shëndetshëm shoqëror, dhe angazhimin e UNMIK-ut për të avancuar përpjekjet në ruajtjen e diversitetit gjuhësor në Kosovë. Deri më sot, fjalori në internet numëron mbi 6000 përdorues aktivë.
38. UNMIK-u vazhdoi me zbatimin e strategjisë së tij kornizë për rininë, për paqen dhe sigurinë. Në janar të vitit 2020, UNMIK, në partneritet me një rrjet shumëtnik lokal të ndërtuesve të rinj të paqes, "Grupi veprues i rinisë së bashkuar", filloi një projekt për krijimin e kapaciteteve që synojnë të nxisin pjesëmarrjen e të rinjve nga të gjitha komunitetet në proceset e vendimmarrjes lokale, përmes forcimit të këshillave komunale rinorë dhe zbatimit të buxhetimit dedikuar të rinjve në dhjetë komuna të përziera etnike. Për më tepër, në zbatimin e Strategjisë së Kombeve të Bashkuara dhe Planit të veprimit mbi gjuhën e urrejtjes, UNMIK-u, në bashkëpunim me "Grupin veprues të rinisë së bashkuar", organizoi një trajnim për një ekip shumëtnik me 37 blogerë dhe aktivistë të rinj (20 femra dhe 17 meshkuj), për njohuritë mbi mediet digjitale dhe mjetet për të identifikuar, dekonstruktuar dhe sfiduar shprehjet e jotolerancës. Gjatë trajnimit që u mbajt nga 22 deri më 24 shkurt, pjesëmarrësit u takuan gjithashtu me përfaqësuesit e Qendrës burimore për personat e zhdukur, të themeluar nga UNMIK-u, dhe të Qendrës së dokumentacionit të Kosovës, për të diskutuar ndikimin e medieve në drejtësinë tranzicionale dhe rolin e të rinjve në ndërtimin e paqes së qëndrueshme. Nga shtatori 2019 deri në shkurt të vitit 2020, si vazhdim i Asamblesë së Tretë të Kombeve të Bashkuara për Rininë, e mbajtur në vitin 2019, UNMIK-u dhe UNICEF-i mbështetën projektin e parë shumëtnik të udhëhequr nga të rinjtë "Nën një qiell". Mbi 630 të rinj (370 femra dhe 260 meshkuj) përfunduan një kurs njëditor mbi astronominë vëzhguese dhe diskutuan mbi edukimin dhe zhvillimin e astronomisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor.
39. Po ashtu, ka vazhduar zbatimi i një projekti të përqendruar tek të rinjtë, i mbështetur nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për ndërtimin e paqes. Përmes këtij projekti, Kombet e Bashkuara në Kosovë në bashkëpunim me Shoqatën e Gazetarëve të Kosovës, ofruan trajnime për mbi 60 gazetarë dhe studentë të gazetarisë (38 gra dhe 23 burra), me qëllim të forcimit të kapaciteteve për të aplikuar një perspektivë gjinore në raportimin e tyre. Në mënyrë të ngjashme, në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, Kombet e Bashkuara mbështetën disa ligjërata me akademikë ndërkombëtarë dhe vendorë për të rritur

ndërgjegjësimin e më shumë se 400 studentëve (231 femra dhe 185 meshkuj), për rëndësinë e përfshirjes domethënëse të grave në ndërtimin e paqes. Sipas të njëjtit projekt, duke u mbështetur në suksesin e nismave ekzistuese të udhëhequra nga të rinjtë dhe të mbështetura nga Kombet e Bashkuara e partnerët e tyre, UNICEF-i ndihmoi 2000 femra dhe meshkuj të rinj nga komunitete të ndryshme, përfshirë 723 adoleshentë, të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të identifikuar sfidat e komunitetit dhe për të gjetur zgjidhje në plotësimin e nevojave sociale. Këto kanë rezultuar në mbi 30 nisma të drejtuara nga të rinjtë.

40. UNMIK-u vazhdoi të fuqizojë angazhimin e tij me organizatat e shoqërisë civile të përqendruara në të drejtat e njeriut, për të kontribuar në dialogun ndërkombëtar dhe për të inkurajuar monitorimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në nivelin bazë, si dhe shqetësimeve të tjera lidhur me të drejtat e njeriut. Nga 20 deri më 22 tetor 2019, UNMIK-u organizoi një seminar mbi mekanizmat ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut dhe raportimin për mbi 20 përfaqësues të shoqërisë civile nga e gjithë Kosova, me qëllim të rritjes së aftësive për të monitoruar dhe raportuar për të drejtat e njeriut dhe të mbështetjes së angazhimit të tyre lidhur me mekanizmat e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut.
41. Misioni vazhdoi të ofrojë shërbime të certifikimit të dokumenteve. Gjatë periudhës raportuese janë përpunuar gjithsej 2213 dokumente, duke përfshirë 1211 dokumente që lidhen me pensionet dhe 1002 me gjendjen civile, siç janë diplomat e shkollës së mesme dhe universitare, si dhe certifikatat e martesës, të lindjes dhe të vdekjes. UNMIK-u vazhdoi të mundësojë bashkëpunimin policor midis autoriteteve të Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, me gjithsej 45 kërkesa të pranuar dhe të trajtuara. UNMIK-u gjithashtu lehtësoi lëshimin e 24 letërthirrjeve të kuqe dhe 15 kërkesave për ekstradim në Kosovë nga anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Policisë për Ndjekje Penale (INTERPOL). Gjithashtu hapi 875 raste për hetime brenda bazës së të dhënave të INTERPOL-it, duke çuar numrin e përgjithshëm të çështjeve të hapura që lidhen me territorin ose popullin e Kosovës në 957. Gjatë kësaj periudhe raportuese, UNMIK-u po ashtu përpunoi 6745 artikuj të korrespondencës zyrtare, si pjesë e funksionit të tij ndërlidhës me INTERPOL-in.

VIII Mbështetja e Misionit

42. Në nëntor të vitit 2019, UNMIK-u u bë operacioni i parë paqeruajtës që arriti standardin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001: 2015 për operacionet e mbështetjes së misionit në terren nga fillimi deri në fund. Certifikimi, i cili është i vlefshëm për një periudhë trevjeçare, është një dëshmi e përpjekjeve të Misionit për të siguruar që operacionet e tij mbështetëse të jenë të orientuara tek klientët, të jenë transparente dhe të përgjegjshme, në përputhje me iniciativën time të reformës së menaxhimit për

të forcuar kulturën e performancës, transparencën dhe përgjegjshmërinë. UNMIK-u ka vazhduar të zbatojë strategjinë e tij trevjeçare të sigurimit të cilësisë, duke konsoliduar pozicionin e tij si një qendër për përsosmëri në Inteligjencën e Biznesit (IB). Misioni ka avancuar në trajnimin e stafit të tij në IB dhe ka implementuar "panelet" e menaxhimit për të monitoruar ndikimin e aktiviteteve programore dhe të iniciativave të tjera kontaktuese si vazhdimësi e Forumit të Kombeve të Bashkuara për Ndërtimin e Besimit në Kosovë.

IX. Ndikimi i Covid-19

43. Më 11 mars 2020, pasi Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) e shpalli shpërthimin e COVID-19 si pandemi, qeveria e Kosovës shpalli masa të caktuara të izolimit, duke përfshirë mbylljen e shkollave dhe pezullimin e udhëtimeve nga vendet me rrezik të lartë dhe të mesëm. Më 12 mars, qeveria themeloi një komision ndërministror, i kryesuar nga kryeministri, që është ngarkuar me detyrën për të parandaluar përhapjen e virusit, duke siguruar shpërndarjen e furnizimeve në qendrat mjekësore dhe shërbimet e urgjencës, si dhe për të akomoduar personat e prekur. Më 13 mars, pas konfirmimit të dy rasteve të para të COVID-19 në Kosovë, qeveria ndërmori masa të mëtejshme, duke përfshirë kufizimin e lëvizjes së njerëzve brenda dhe jashtë dy komunave të prekura, duke mbyllur të gjitha pikat e kalimit tokësor dhe duke pezulluar gjithë transportin publik ndërmjet qyteteve dhe linjat e rregullta ajrore tregtare. Më 15 mars, qeveria shpalli emergjencën e shëndetit publik pasi numri i rasteve të konfirmuara u rrit në nëntë (pesë gra dhe katër burra).
44. Kombet e Bashkuara në Kosovë vazhdojnë funksionimin me kapacitete të plota, megjithë zbatimin e masave për zvogëlimin e rreziqeve, siç janë puna nga shtëpia e stafit joesencial dhe transferimi në platformat e komunikimit virtual, megjithëse me mundësi të kufizuara për të zbatuar aktivitete programore dhe projekte për ndërtimin e besimit. Në frymën e "Një KB", Misioni dhe ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë kanë bashkërenduar ngushtë për çështje që lidhen me parandalimin mjekësor, gatishmërinë dhe reagimin, përfshirë edhe përmes zbatimit të planeve përkatëse të vazhdimësisë së punës. U krijua një grup veprues ndërmjet agjencive, i kryesuar nga UNMIK-u, për të mbështetur dhe koordinuar prokurimin e furnizimeve dhe pajisjeve mjekësore. Koordinimi i Kombeve të Bashkuara me Ministrinë e Shëndetësisë së Kosovës është udhëhequr nga OBSH-ja dhe Koordinatori i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin që nga fillimi i krizës. Në fund të periudhës raportuese, nuk kishte raste të konfirmuara të COVID-19 në mesin e punonjësve të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

X. Vrojtimet

45. Zgjedhjet e fundit në Kosovë çuan në një tranzicion paqësor të pushtetit me një qeveri të re të formuar për herë të parë nga opozita e mëparshme. Rezultati i zgjedhjeve paraqiti një ndryshim të madh në skenën politik në Kosovë, duke

reflektuar dëshirën e një pjese të madhe të popullatës së Kosovës për ndryshim politik. Qeveria e re ka caktuar një agjendë ambicioze të reformave, veçanërisht në sundimin e ligjit dhe në fushat e zhvillimit ekonomik, të cilat kanë qenë sfida për një kohë të gjatë në Kosovë, dhe që janë prioritetet e KB-së në të gjithë botën. Suksesi i këtyre përpjekjeve do të kërkojë vullnet politik dhe angazhim nga qeveria e re, si dhe mbështetje nga jashtë për të pasur sukses. Përfaqësimi më i madh i grave në udhëheqjen e Kuvendit dhe ekzekutivit është inkurajues dhe duhet të frymëzojë rritjen e pjesëmarrjes së grave në Kosovë në proceset e vendimmarrjes, si dhe në dialogun midis Prishtinës dhe Beogradit. Qeveria dhe Kuvendi duhet të përfshijnë të gjitha segmentet e shoqërisë, veçanërisht ato që janë lënë anash dhe ato që nuk janë të përfaqësuara, në diskutimet mbi çështjet më të ndjeshme me të cilat përballet Kosova.

46. Përveç reformës institucionale, vazhdimi i procesit të normalizimit me Beogradin është në ballë të pritjeve ndërkombëtare. Është esenciale që pengesat për vazhdimin e dialogut produktiv të hiqen sa më shpejtë. Unë jam i inkurajuar nga vendosmëria personale e shprehur nga përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë dhe zëvendëspresidenti i Komisionit Evropian, për të drejtuar punën në rifillimin e dialogut të përkrahur nga BE-ja. Unë gjithashtu mirëpres hapat e prekshëm të ndërmarrë nga Beogradi dhe Prishtina, me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara, për të promovuar lidhjen dhe bashkëpunimin rajonal duke u angazhuar për të punuar drejt lidhjeve direkte ajrore, hekurudhore dhe rrugore.
 47. Duke pranuar sfidat, unë jam megjithatë i inkurajuar nga aktivitetet e grupit të përbashkët punues Beograd-Prishtinë për personat e zhdukur, i cili vazhdon të punojë me pjesëmarrjen dhe mbështetjen e UNMIK-ut, si dhe agjencive të tjera. Për të sjellë përgjigje të shumëpritura për familjet, është shpresa e fortë që individët me informacione të rëndësishme do të vazhdojnë të paraqiten dhe të komunikojnë me grupin e përbashkët punues.
 48. Unë e përgëzoj Misionin për avancimin e agjendës së tij të ndërtimit të besimit përmes një sërë iniciativash në bashkëpunim me qeverinë, me shoqërinë civile, me organizatat ndërkombëtare dhe me partnerët diplomatikë. UNMIK-u, duke bashkëpunuar me ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, është përqendruar në fushat që janë esenciale për pajtimin shoqëror në Kosovë, dhe të cilat janë të domosdoshme për dialog, për kompromis dhe paqe të qëndrueshme. Përpjekjet kolektive të Kombeve të Bashkuara janë përqendruar në fuqizimin e grave, të rinjve, shoqërisë civile dhe medieve profesionale, dhe në mbështetjen për krijuesit e tjerë të ndryshimeve pozitive në mbarë Kosovën. Projektet e përqendruara në krijimin e kapaciteteve institucionale dhe promovimin e shumëgjuhësisë, kanë përforcuar mbështetjen e Misionit për institucionet e Kosovës në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Shpresoj se kjo punë mund të zgjerohet për t'u lidhur me nisma të ngjashme në gjithë rajonin.
-

49. Dua të ritheksoj rëndësinë e fondit të mirëbesimit të Kombeve të Bashkuara për mbështetjen e komunitetit ashkali, egjiptas dhe rom të prekur nga helmimi me plumb në Kosovë. Është përgjegjësia jonë e përbashkët të sigurojmë mbështetje dhe ndihmë për komunitetet e prekura. Fondi ka marrë vetëm një zotim deri më tani, dhe unë u bëj thirrje edhe njëherë shteteve anëtare, akterëve të tjerë dhe organizatave të kontribuojnë në fondin e mirëbesimit.
50. E falënderoj përfaqësuesin tim special, Zahir Tanin, dhe gjithë stafin e UNMIK-ut për energjinë, për kreativitetin dhe përkushtimin që ata dhanë në punën e Misionit. Në fund, dëshiroj të ritheksoj mirënjohjen time për partnerët e përhershëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë: KFOR-in, OSBE-në, Bashkimin Evropian dhe agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara për kontributin dhe bashkëpunimin e tyre.

Shtojca I.

Raporti i Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë dërguar Sekretarit të Përgjithshëm për aktivitetet e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, nga 16 shtatori 2019 deri më 15 mars 2020.

1. Përmbledhje

Zyrtarët gjyqësorë adresuan një sërë çështjesh të identifikuara nga Njësia e EULEX-it për monitorimin e lëndëve (në fushën e mandatit të saj të monitorimit), siç janë eliminimi i ndërhyrjeve të mundshme të paligjshme duke zbatuar shortin e automatizuar për caktimin e gjyqtarëve në trupat gjykues, shmangia e përdorimit të trupave gjykuese fikse në departamentin special të gjykatës themelore të Prishtinës, si dhe angazhimi në ndërmarrjen e hapave për të ulur shkallën e lartë të seancave gjyqësore joproductive. Këto masa kanë për qëllim forcimin e qasjes në drejtësi dhe përmirësimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit.

Njësia e EULEX-it për monitorimin e lëndëve vazhdoi monitorimin e saj të ngushtë të ish-lëndëve të EULEX-it dhe lëndëve të tjera të profilit të lartë. Misioni vërejti pak përparim në hetimin e rasteve të tilla në nivelin e policisë dhe të prokurorisë.

Në mbështetje të dialogut të përkrahur nga Bashkimi Evropian, Misioni vazhdoi të mbështesë zbatimin teknik të protokollit teknik të MIK dhe marrëveshjeve të dialogut që lidhen me lirinë e lëvizjes. Lidhur me këtë të fundit, ministri i Punëve të Brendshme vazhdoi afatin e dy vendimeve ministrore për lejet e vozitjes dhe dokumentet e gjendjes civile. Misioni gjithashtu vazhdoi të mbështesë gjykatën themelore të Mitrovicës dhe divizionin e gjykatës së apelit në Mitrovicë në zbatimin e marrëveshjes për drejtësi.

EULEX-i vazhdoi të përkrahë Policinë e Kosovës në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor në nivele të ndryshme. Përmes Institutit të Mjekësisë Ligjore, mbështetje iu dha homologëve vendas në gjetjen dhe identifikimin e personave të zhdukur. Për më tepër, Misioni vazhdon t'i ketë në gatishmëri kapacitetet e tij për ndërhyrje të shpejtë si reagues i dytë i sigurisë, dhe vazhdoi mbështetjen e tij për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

2. Aktivitetet e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX Kosovë)

2.1. Monitorimi

Misioni vazhdoi monitorimin e tij të ngushtë të lëndëve dhe gjykimeve të zgjedhura në sistemin e drejtësisë, të ish-lëndëve të EULEX-it dhe të lëndëve ad hoc.

Në janar të vitit 2020, Këshilli Gjyqësor i Kosovës miratoi kritere për caktimin e lëndëve gjyqësore përmes një sistemi elektronik në të gjitha gjykatat e Kosovës. Ky sistem siguron “shortin” për caktimin e lëndëve, i cili do të ndihmojë në kufizimin e ndërhyrjeve të jashtme. Caktimi i parë automatik i lëndëve filloj në të gjitha gjykatat themelore në Kosovë më 18 shkurt.

Këshilli njoftoi po ashtu se do të shqyrtojë arsyet e numrit të madh të seancave gjyqësore joproductive dhe do të marrë masa për ta zvogëluar atë. Shefi i departamentit të posaçëm të krijuar kohët e fundit në gjykatën themelore të Prishtinës, informoi EULEX-in se departamenti special kishte vendosur të mos përdorte më trupa gjyqësore fikse në proceset gjyqësore të tij. Këto tri vendime të rëndësishme, të gjitha të marra në përputhje me rekomandimet e Misionit, pritet të kontribuojnë në një rritje të qasjes në drejtësi, si dhe në një perceptim të përmirësuar të pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit në Kosovë. Duke pasur këtë parasysh, monitorimi i disa lëndëve të profilit të lartë zbuloi indikacione të ndërhyrjes së paligjshme në procedurat gjyqësore.

EULEX-i vazhdoi të mbështesë Njësinë e Policisë së Kosovës për hetimin e krimeve të luftës me krijimin e një baze të re të dhënash për krimet e luftës, përfshirë përmes sigurimit të masave të përshtatura të trajnimit për kërkimin dhe menaxhimin efikas të bazës së të dhënave. Një pjesë e ndihmës së EULEX-it konsiston në zhvillimin e një sistemi për grumbullimin e lëndëve të ngjashme me qëllim të zvogëlimit të numrit të tyre në një madhësi të menaxhueshme. Me një kërkesë të lëshuar nga Policia e Kosovës, Misioni do të vazhdojë të ndihmojë policinë gjatë muajve të ardhshëm për të siguruar që projekti të përfundojë me sukses. Derisa disa zhvillime pozitive në lëndët e krimeve të luftës ishin të dukshme, nuk u pa përparim në hetimin e lëndëve të profilit të lartë.

EULEX-i ka vërejtur përmirësime të konsiderueshme në aspekte të caktuara të trajtimit të rasteve të dhunës seksuale nga Policia e Kosovës. Këto përfshijnë, ndër të tjera, referimin e saktë të lëndëve në institucione të tjera për të siguruar ruajtjen e provave biologjike, si dhe një qasje dhe gatishmëri gjithnjë e më e madhe e paanshmërisë për të hetuar të gjitha aspektet dhe drejtimet e mundshme. Sidoqoftë, zbatimi i një qasjeje të bazuar tek viktima, veçanërisht me të mitur, mbetet një përjashtim, dhe Policia e Kosovës ende nuk kishte burime të mjaftueshme teknologjike për të hetuar siç duhet raste të tilla. Misioni vërejti që dënimet minimale shpesh shqiptoheshin në raste të dhunës në familje, dhe rrethanat rënduese nuk u morën parasysh, megjithë detyrimin e qartë që këto të merren parasysh sipas Kodit të ri Penal.

Mbështetja e Misionit për menaxhmentin e lartë të Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK) nuk përparoi në mënyrë të konsiderueshme duke pasur parasysh që as veprimet dhe as vendimet për strukturën e re të SHKK-së nuk ishin marrë nga qeveria në largim, dhe as nuk ishin kryer rekrutime të jashtme. Po kështu, nuk ka pasur përparim në ndryshimin e kornizës ligjore që prek SHKK-në.

Monitorimi i transportit të të burgosurve me profil të lartë zbuloi disa çështje të vogla shqetësuese, kryesisht të nivelit teknik. Me qëllim të eliminimit të boshllëqeve ekzistuese, Misioni dha sugjerime dhe rekomandime për një rregullore mbi transportin e të burgosurve, të hartuar së fundmi nga SHKK-ja.

Krahas akterëve të tjerë ndërkombëtarë, EULEX-i mbështeti zhvillimin e një strategjie dhe plani të veprimit për trajnimin e stafit të SHKK-së në periudhën 2020-2024. Për më tepër, Misioni dhe një projekt binjakëzimi i BE-së bashkërisht përkrahën SHKK-në në hartimin e një rregulloreje që

u mundëson të burgosurve të punojnë jashtë ambienteve korrektuese, zbatimi i të cilave filloi në nëntor si pilot në një institucion. Me kërkesën e SHKK-së, Misioni kreu një rishikim të rregullores dhe prezantoi gjetjet dhe rekomandimet e tij. Në shkurt, Misioni i dërgoi drejtorit të përgjithshëm të SHKK-së një raport tematik me titull "themelimi i njësisë së vlerësimit dhe klasifikimit të të burgosurve në Shërbimin Korrektues të Kosovës", duke rishikuar hapat e bërë deri më tani, duke theksuar mbështetjen intensive të Misionit në këtë fushë, si dhe ofrimin e rekomandimeve për hapat e ardhshëm në këtë proces.

Misioni vazhdoi të mbështesë zbatimin e Protokollit Teknik të IMK-së që rrjedh nga dialogu i mbështetur nga BE-ja. Nuk ka pasur zhvillime të reja në lidhje me ndërtimin e parashikuar të gjashtë vendkalimeve të përbashkëta të përhershme (VPP) midis Kosovës dhe Serbisë. Autoritetet serbe qëndrojnë në kontejnerët e përkohshëm në VPP në Merdarë dhe Mutivodë, megjithëse ndërtimi i vendkalimeve të përbashkëta të përhershme në këto lokacione përfundoi në mesin e vitit 2019.

Misioni vazhdoi të përkrahë zbatimin teknik të marrëveshjeve të Dialogut të mbështetur nga BE-ja që lidhen me lirinë e lëvizjes. Siç u këshillua nga EULEX-i, ministri i Punëve të Brendshme vazhdoi afatin e dy vendimeve ministrore, të nevojshme për zbatimin e këtyre marrëveshjeve. Kjo i referohet një vendimi që lejon kthimin e lejeve të vozitjes të Serbisë në ato të Kosovës, si dhe një vendimi për pranimin e certifikatave serbe të lindjes, të martesës dhe të vdekjes, për të aplikuar për çfarëdo dokument identifikimi të Kosovës.

Misioni vazhdoi të mbështesë gjykatën themelore të Mitrovicës dhe divizionin e gjykatës së apelit në Mitrovicë në zbatimin e Marrëveshjes për drejtësi të përkrahur nga BE-ja.

2.2. Operacionet

EULEX-i vazhdoi të përkrahë Policinë e Kosovës në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor. Misioni mundësoi shkëmbimin e informacioneve ndërmjet zyrave qendrore nacionale të Interpolit dhe Njesisë koordinuese të Policisë së Kosovës për zbatimin e ligjit ndërkombëtar, nën ombrellën e Zyrës ndërlidhëse të Interpolit brenda Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Në rolin e tij mbështetës midis Europol-it dhe Policisë së Kosovës, EULEX-i ofroi mbështetje të inteligjencës kriminale për shtetet anëtare të BE-së dhe hetimet në vendet e treta, si dhe mundësoi shkëmbimin e informacioneve midis Policisë së Kosovës dhe Ministrisë së Brendshme të Serbisë. Në nëntor të vitit 2019, Misioni zhvilloi një punëtori mbi parimet e bashkëpunimit policor ndërkombëtar në fushën e krimeve mjedisore, e pasuar nga një vizitë studimore në Itali në dhjetor.

Instituti i Mjekësisë Ligjore vazhdoi punën e tij për gjetjen dhe identifikimin e personave të zhdukur, si dhe mbështetjen e homologëve vendas. Në shtator të vitit 2019, Instituti i Mjekësisë Ligjore, në bashkëpunim me EULEX-in dhe Policinë e Kosovës, filluan një fushatë sensibilizuese të titulluar "Flisni në kohë" për rëndësinë e ruajtjes së provave biologjike në rastet

e dhunës seksuale. Qindra studentëve u janë dhënë informacione të rëndësishme gjatë punëtorive në shkolla në tërë Kosovën.

Njësia policore e krijuar nga EULEX-i ka mbajtur në gjendje gatishmërie kapacitetet e saj të ndërhyrjes së shpejtë si reaguese e dytë e sigurisë. Në janar, kjo njësi kreu dy ushtrime me KFOR-in mbi evakuimin mjekësor dhe kontrollin e turmave dhe trazirave. Asnjë masë e përbashkët trajnuese nuk është kryer me Policinë e Kosovës.

EULEX-i vazhdoi të mbështesë Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar brenda mjeteve dhe mundësive të tij.

Shtojca II.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar

Në shkurt, Prokurori i Specializuar njoftoi kryetarin e Dhomave të Specializuara (DHS) për qëllimin e tij për të filluar procedurë gjyqësore në përputhje me nenin 38 (4) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, me ç'rast kryetari caktoi një gjyqtar të procedurës paraprake në përputhje me këtë.

Më 13 janar, një trup gjykues i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Kushtetuese e shpalli të pranueshme një kërkesë nga një individ i thirrur i cili kundërshtoi ligjshmërinë e procesit të intervistimit të Prokurorit të Specializuar. Për më tepër, gjyqtari për ankesat e stafit dhe gjykatësi i lartë për ankesat e stafit nxorën katër vendime midis shtatorit dhe dhjetorit të vitit 2019 mbi ankesat e pjesëtarëve të stafit të UK në lidhje me statusin e tyre kontraktues në DHS dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS).

Më 6 janar, Dhomat e Specializuara morën në posedim objektin e tyre pas përfundimit të negociatave me shërbimin holandez të burgjeve për shpenzimet e paraburgimit në fund të vitit 2019. Rregullat e paraburgimit përputhen me standardet ndërkombëtare, veçanërisht me rregullat evropiane të burgjeve dhe rregullat minimale standarde të Kombeve të Bashkuara për trajtimin e të burgosurve (Rregullat e Nelson Mandelës).

Gjatë periudhës raportuese, Sekretaria e mbështeti grupin e punës për listën e përfaqësuesve në hartimin e një kushtetute për Organin përfaqësues të pavarur të avokatëve të specializuar (OPP). Grupi i punës u takua në Hagë në DHS për të përfunduar kushtetutën që u miratua më 4 dhjetor nga përfaqësuesit në listë. Me miratimin e kushtetutës së tij, OPP u krijua zyrtarisht dhe mund të konsultohet nga DHS për ndryshimet në kornizën e tij ligjore. Konsultimi i parë me OPP për ndryshimet e propozuara në Rregulloren e Punës dhe Provave (RPP) u mbajt në janar.

Në fund të vitit 2019, presidenti aktivizoi Komitetin legjislativ me qëllime të shqyrtimit të ndryshimeve të propozuara në RPP, veçanërisht ato rregulla që u testuan gjatë hetimeve dhe operacioneve të ZPS.

Kryetari i DHS dhe sekretari bashkëpunuan ngushtë me shtetin nikoqir dhe shtetet e tjera anëtare të BE-së. Më 10 dhjetor, kryetari, sekretari dhe Prokurori i Specializuar pritën SHA-të e BE-së dhe shtetet e treta kontribuese në sallën e tyre për konferencën vjetore. Në konferencë, kryesuesit njoftuan për aktivitetet e fundit dhe adresuan pyetjet e pjesëmarrësve. Kjo ishte konferenca e katërt e këtij lloji që u prit nga kryesuesit.

Në dhjetor u publikua thirrja për emërimet e gjyqtarëve për t'u caktuar në listën e gjykatësve ndërkombëtarë (regjistër) me datën e mbylljes deri më 17 mars.

Rrjeti i informacionit për gjykatat e DHS, një rrjet i përbërë nga 15 përfaqësues të OJQ-ve nga Kosova dhe Serbia, u takua më 6 shkurt në Prishtinë për një punëtori në terren. Punëtorja këshilluese u përqendrua në dhënien e informatave mbi rezultatet specifike në terren të DHS.

Për më tepër, rrjeti siguroi një pasqyrë të vlefshme mbi mënyrën më të mirë për të komunikuar mesazhet e DHS në rajone të caktuara, dhe bëri vlerësimin e aktiviteteve në terren të DHS në mënyrë që ato të zhvillohen më tutje.

Gjatë periudhës raportuese, u mbajtën 16 takime me përfaqësuesit e shoqërisë civile në Kosovë në kuadër të programit të DHS në terren. Kah fundi i vitit 2019, programi u zhvendos në fazën e tij të dytë. Faza e parë u dedikua kryesisht në krijimin e një dialogu me shoqërinë civile në Kosovë dhe sigurimin e shpërndarjes së informacioneve bazike të sakta për Gjykatën. Faza e dytë synon të rrisë shpërndarjen e informacionit për DHS tek publiku i gjerë përmes medieve tradicionale dhe sociale, dhe të sqarojë fazën paraprake dhe atë gjykuese të procedurave të DHS.

Si rezultat i veprimtarisë së ZPS-së, zyra e mbrojtjes ka trajtuar tri kërkesa për ndihmë juridike dhe ka caktuar përfaqësues (me prokurë) në përputhje me rregullat, si dhe ka caktuar 12 përfaqësues dhe tre bashkëpërfaqësues. Në listë aktualisht janë 174 përfaqësues që kanë të drejtë të paraqiten pranë DHS, nga të cilët 88 përfaqësues kanë të drejtë të përfaqësojnë viktimat. Procesi i aplikimit mbetet i hapur.

Gjatë periudhës raportuese, sekretaria e rriti mbështetjen e saj administrative për ZPS, përfshirë edhe në fushat e TI dhe shërbimeve gjuhësore, për të siguruar që Prokurori i Specializuar të mund të përqendrojë të gjitha burimet e tij të disponueshme në hetime.

Në periudhën raportuese, Zyra e Prokurorit të Specializuar avancoi me hetimet e saj dhe vazhdoi të intervistojë të dyshuarit, viktimat dhe dëshmitarët, si dhe të mbledhë dhe shqyrtojë prova të tjera. Për të përmbushur mandatin e tij, ZPS kërkon angazhim dhe mbështetje të shtuar të bashkësisë ndërkombëtare, të organizatave ndërkombëtare dhe të shteteve veç e veç.

Shtojca III

Përbërja dhe kapacitetet e komponentit policor të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (deri më 15 mars 2020)

Shteti	Gra	Burra	Numri
Austria	1		1
Gjermania	1	1	2
Hungaria		2	2
Federata ruse	1	1	2
Turqia		1	1
Ukraina		1	1
Gjithsej	3	6	9

Përbërja dhe kapacitetet e komponentit ndërlidhës ushtarak të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (deri më 15 mars 2020)

Shteti	Gra	Burra	Numri
Republika Çeke		2	2
Polonia		1	1
Republika e Moldavisë		1	1
Rumania		1	1
Turqia		1	1

Ukraina	2	2
---------	---	---

Gjithsej	88	
-----------------	-----------	--